

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD**

“NOVATECH STUDIO ”sh.p.k

RAPORTI TEKNIK



**NDERTIMI I BAZAMENTEVE TE URES NE
PRROIN RINASIT, FSHATI GURE KUQ**

2022

HYRJE

Gjendja aktuale e vendit ku do te ndertohet bazamentet e ures.

Vendi i studimit ku do te ndertohen bazamentet e ures eshte fshati Gure Kuq bashkia Librazhde. Gjendja aktuale te ketij vendi eshte kalimi i rruges ekzistuese permes shtratit te prroit. Pikerisht ky kalim veshtiresohet dhe ne raste te vecanta behet i pamundure ne pjesen me te madhe madhe te vitit , per shakake te rritjes se prurjes te prroit gjate periudhave me shi. Gjithashtu ne perkeqesim e kalimit te ketij prroit pervec prurjeve qe shkojne deri ne kouten N.N.U (niveli maksimal i ujite)- 529.00m, nje faktore eshte dhe shpejtesia e madhe e prroit. Kerkesa e investitorit eshte projektimi i i bazamenteve te ures , ndersa pjesa kaluese e ures (soleta e urese) nuk eshte objekt i ketij projekti. Pasi jemi njohur me kerkesat e investitorit menjehere eshte bere studimi i karakteristikave hidrologjike te prroit te Rinasit . Sipas te dhenave hidrologjik te marra nga IGJEUM dhe perpunimi i tyre del qe niveli maksimal i uji N.M.U ne pozicionin ku eshte menduar te ndertohen bazamente 529.00m , gjithashtu niveli normal i ujit eshte kouta 529.00 mm. Si perfundim proi mbi te cilin do te kaloj ura ka nje ngritje prej 1 m nga niveli normal ne rastin e rreshjeve te shumta te shiut.



RELACIONI TOPOGRAFIK

Koutat qe jane perdorur per studimin e topografise se terrenit, jane koutat e nxjerra nga matjet e bera ne te gjitha aksin e ures Ne baze te ketyre eshte bere nje rilevim i plote i zones ku do te nderhyhet.

Pikat dhe koordinatat konkrete ku ne kemi vendosur bazën e GPS-it tonë janë te dhena ne planimetrite perkatese.

Saktësia e realizuar në matje me GPS-in tonë është +- 1 cm në plan dhe +- 1.5 cm në kuotat për një rreth me rreze 5 000 metra (ose diametër 10 000 metra). Kjo saktësi është maksimalisht e mjaftueshme për kërkesat teknike të projektit.

Në të gjithë zonen e rilevuar ne kemi vendosur disa pika të forta me gozhde betoni dhe kunjat hekuri

të cilat do të shërbejnë gjatë zbatimit të projektit (pikat poligonale).

Këto pika poligonale u shfrytëzuan njëkohësisht për gjithë rilevimin e zones.

Rilevimi është realizuar në këto mënyra:

Si fillim që në momentin e parë është bërë rikonjicioni i zones dhe është vendosur për mënyrën kryerjes së këtij procesi. Duke menduar që të dhënat topografike do të jenë sipas rrjetit koordinativ shtetëror është filluar me grumbullimin e materialeve të nevojshme për transformimin e të dhënave tona në këto rrjet. Kështu nga hartat 1:25 000 të zones janë identifikuar pikat e triangolacionit Shqiptar dhe janë marrë të dhënat nga Instituti Gjeografik i Tiranës për këto pika si dhe listën e reperave dhe të markave në këto zone. Me pas është zhvilluar një rrjet poligonal i mbështetur në këto pika dhe duke përdorur teknologjinë GPS.

Është ndërtuar një rrjet për llogaritjen e koordinatave të pikave të poligonit në mënyrën më të saktë të mundur. Pasqyrimi/materializimi në terren që është bërë pikave poligonale të matura me GPS, është bërë edhe për pikat fikse të fillimit dhe të mbarimit të rrugëve/veprave kryesore, si dhe pikat e tjera të rëndësishme që janë gjykuar të domosdoshme.

Të gjitha pikat e rilevuara në terren janë të regjistruara me kode speciale në memoriet e brendshme të instrumentave të përdorura nga ana jonë. Pikat e regjistruara në terren janë transferuar në kompjuter me programet e realizuara përkatësisht për këto procese. Me vone të gjitha pikat janë përpunuar dhe u bë krijimi i hartës dixhitale në shkallë reale në kompjuter. Në terren janë rilevuara të gjitha pikat karakteristike për të pozicionuar të gjitha detajet. Rëndësi të veçantë është kushtuar pozicionimit të detajeve si: ndërtimet e ndryshme civile, elementet e infrastruktures, etj.

Programi që është përdorur ka të vizatuar të gjithë elementet planimetrik. Të dhënat finale janë "file" dwg si dhe një Model i Terrenit në formë dixhitale në formatin DXF për projektimin e veprave të ndryshme sipas programeve përkatëse. Të dhënat dixhitale përmbajnë të gjitha linjat e ndërprerjes së terrenit për një ndërtim shumë të mirë të modelit tridimensional. Të gjitha detajet topografike janë të pranishme.


Izoipset janë krijuar nëpërmjet programit përkatës.



Ne foto :matjet me GPS në pika të ndryshme


ZGJIDHJA TEKNIKE

Pas rilevimit topografik te zones ku do te ndertohen bazamentet e ures eshte bere zgjidhja e aksit me optimal te ures duke u ruajtur dhe aksin e rruges . Me pas eshte bere modelimi i siperfaqes dhe nxjerra e profilave gjatesore sipas aksit te menduar per vendosjen e ures nepermjet programit Autocad Cvil 3D. Pasi eshte studiuar profili gjatesore kemi te bejme me nje **hapsire aksiale 18.30 m.**




BAZAMENTET E URES

Konstruksion i bazamenteve eshte menduar bazamente prej betoni te armuar C30/37. Bazamentet kane nje lartesi prej 8 m dhe gjeresi 6m. Per shkak te pozicionit ne dy anet e shtratit te lumit eshte menduar qe 4.4 m te futen ne germim derisa te arrihet inkastrimi i bazamenteve ne shkembinj natyrore. Gjeresi e bazamenteve ne koke eshte 1.2 m dhe me pas zgjerohet sipas shkallezimeve , duke perfunduar ne nje themel me gjeresi 3.7 m dhe lartesi 2 m. Kouta e soletoneve te ures do te jete 533.00 duke bere qe ura te kete nje lartesi nga niveli maksimal i ujit prej 4 m .




ARMIMI I BAZAMENTEVE TE URES


Armimi i Bazamentet te ures eshte bere sipas KTP ku diametri i shufres se perdorur eshte 20 mm .
 . Ne projekt eshte paraqitur konstruktimi i bazamenteve tte ures.



DETAJE/ARMIMI I SHPATULLES A SHK 1:75







RREZHEJONI	DIAMETRI Ømm	Gjatësia L, cm	Copë	Gjatësia L, total cm	Gjatësia L, total m	TOTALE			
						DIAMETRI Ømm	Lit.m	Pesha (nd)	Pesha (kg)
1	20	700	30	21000	210	1332	2.466	3204.7	
2	20	390	30	11700	117	Skema		3204.7	
3	20	700	30	21000	210	Skema			
4	20	390	30	11700	117	14	1008.4	1.21	1220.2
5	20	370	30	11700	117	Skema		1320.2	
6	20	430	30	13100	131	Skema			
7	20	710	30	21300	213	16	278.4	1.378	419.3
8	20	710	30	21300	213	Skema		419.3	
9	14	780	10	7800	78	Skema			
10	14	780	10	7800	78	10	138	0.62	81.6
11	14	830	10	8300	83	Skema		81.6	
12	14	830	10	8300	83	Skema			
13	14	880	10	8800	88	Skema			
14	14	880	10	8800	88	Skema			
15	16	180	24	19200	192	Skema			
16	16	580	12	6960	69.6	Skema			
17	16	580	12	6960	69.6	Skema			
18-STAPA	10	250	80	18000	180	Skema			



Armimi i bazamenteve te ures

SPERONET E URES


Per mbrotjen e bazamenteve te ures nga grryerjet e proit eshte menduar dhe ndertimi i kater speroneve prej b/a. Me dimensione sic jane paraqitur ne projekt .



LIDHJA E URES ME RRUGEN EKZISTUESE

Per te bere mundur lidhje e rruges ekzistuese me uren do te behet ndertimi i rampave kaluese 25-30 m nga dy anet e rruges sipas profilit tip ne projekt.

PROFIL TIP RRUGA
SHK 1:25



PERGATITI

“NOVATECH STUDIO “shpk

Administrator
Ing.Emil Nova

Tirane , 2022